



Koalicioni Shqiptar “Bashkë Kundër Trafikimit të Fëmijëve”
The Albanian Coalition “All Together Against Child Trafficking”

Adresa: Rruga Nikolla Tupe, Nr. 17
Tiranë, Shqipëri
E-mail: danjela.shkalla@bktf-coalition.org
Tel: +355 68 20 26 662

Deklaratë për Shtyp

Forumi: “Mbrotjtja e Fëmijëve- Çështje e të Gjithëve!”

16.07.2010. Koalicioni “Bashkë Kundër Trafikimit të Fëmijëve” dhe UNICEF, lançuan sot Forumin me temë “Mbrotjtja e Fëmijëve- Çështje e të Gjithëve!”.

Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga MPCSSHB, MASH, Ministria e Brendshme, shoqëria civile, policia e shtetit, dhe përfaqësues të rinjve nga shkolla të ndryshme, për të trajtuar së bashku disa nga çështjet kryesore të cilat prekin sistemin e mbrotjtjes së fëmijëve në Shqipëri.

Pjesëmarrësit u ulën në tryeza të rrumbullakëta dhe ndanë shqetësimet kryesore që lidhen me braktisjen e shkollës, pamundësinë për t’u regjistruar në shkollë, mungesën e aksesit të shumë fëmijëve në shërbimet shëndetësore, mungesa e librezave shëndetësore për fëmijët, problemet që puna e fëmijëve sjell te vetë fëmijët, pasiguria e internetit për fëmijët, rëndësia e kujdesit prindëror, rëndësia e medias në informimin dhe edukimin e të rinjve dhe rëndësia dhe përgjegjësia që familja dhe komuniteti kanë për të ofruar një mjedis mbrotjtës për të gjithë fëmijët.

Gjatë takimit përfaqësuesja e MPCSSHB, Znj. Denada Seferi shpreh: “Pavarësisht se janë marrë disa hapa konkretë nga shteti shqiptar për përmirësimin e sistemit të mbrotjtjes së fëmijëve, mbetet shumë për të bërë, sidomos në aspektin e ofrimeve të shërbimeve sociale dhe jo vetëm në ndihmën në kesh për fëmijët në situatë rruge, fëmijët në qendra ditore, fëmijët që punojnë, apo fëmijët më aftësi të kufizuara.”

Ndërsa Znj. Enkelejda Lopari, presidente e BKTF theksoi se “Fëmijët kanë të drejtë të dëgohen, të marrin pjesë në vendimmarrje, të japin mendimin e tyre për çështje që prekin vetë ata, dhe përgjegjësia kryesore për t’u krijuar atyre një mjedis të sigurt është e të gjithë ne.”

Këto forume synojnë që të angazhojnë institucionet shtetërore, organizatat jo-fitimprurëse të cilat punojnë në fushën e të drejtave të fëmijëve, median, biznesin privat, profesionistët e fushave të ndryshme, si dhe vetë fëmijët dhe të rinjtë, në debate diskutimi mbi çështjet që shqetësojnë gjithë shoqërinë shqiptare, në lidhje me mbrotjtjen e fëmijëve, si një e drejtë e rëndësishme e parashikuar në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Gjithashtu, këto forume do të synojnë të rrisin pjesëmarrjen e vetë fëmijëve dhe komunitetit në çështje sociale të cilat prekin vetë ata. Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve dhe partnerëve socialë, vetë fëmijët dhe komuniteti do të influencojë marrjen e masave konkrete për përmirësimin e sistemit të mbrotjtjes.

Në këtë lançim kishte dhe fëmijë të cilët prezantuan një nga çështjet kryesore që prek shumë nga bashkëmoshatarët e tyre, braktisja e shkollës. Ky problem nuk është vetëm i fëmijëve që nuk shkojnë në shkollë por është i të gjithëve dhe është një pengesë dhe për anëtarësimin e Shqipërisë në Europë, tha një nga fëmijët prezent në aktivitet. Alba, një tjetër fëmijë i pranishëm e mbylli fjalën e saj me thirrjen “Fëmijët në nevojë nuk kanë nevojë për mëshirë, por për mbështetje!”

Koalicioni BKTF, përbëhet nga 25 organizata kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat advokojnë dhe llojnë për mbrotjtjen e fëmijëve shqiptarë nga të gjitha format e dhunës, neglizhimit, shfrytëzimit dhe abuzimit, bazuar në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve dhe në legjislacionin shqiptar dhe instrumente dhe mekanizma të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, duke bashkuar përpjekjet, eksperiencat dhe të gjitha mjetet në dispozicion.